



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur ndërmjet palëve

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë i përfaqësuar nga, Prof.Dr. Armand Krasniqi në cilësinë e Rektorit të këtij institucioni të arsimit të lartë (në tekstin e metutjemë Universiteti)

dhe

Organizata jo Qeveritare **Volontari nel Mondo RTM**, ne vazhdim "RTM", me seli ne Rr. Kadri Gjata, nr. 25, Lagjia Tophane, Prishtinë, me nr. regjistrimii 5300131-9, përfaqësuar nga Valentina Gjinaj në rolin e Përfaqësuesit Ligjor.

Neni 1 **Qëllimi**

Oëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është përcaktimi i fushave dhe mënyrave të bashkëpunimit në mes të dy entiteteve të sipërshenuara. Të dy entitetet kanë një interes të përbashkët në zhvillimin e njohurive për sektorin e turizmit në Kosovë dhe në ngritjen e vetëdijes për turizmin e qëndrueshëm në vend.

Neni2 **Baza ligjore**

Ky memorandum është i bazuar në tërësi mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve të cilat i kane të përcaktuara në Ligjin për Arsimin e lartë, si dhe përkatesisht në Ligjin për lirinë e Asociimit të Republikës së Kosovës

Neni3 **Forma e Bashkëpunimit**

Palet bien dakord që të bashkëpunojnë në fushat vijuese:

- i. Konceptimin, zhvillimin dhe realizimin e bashkëpunimeve të përbashketa në fushen e zhvillimit ekonomik dhe rural, dhe turizmit të përgjegjshëm, me theks të vecantë në atë që ndërlidhen me projektin NaturKosovo (finacohet nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor – AID12382) të bartur nga Volontari nel Mondo RTM
- ii. Mbështetien e ndërsjellët profesionale në realizimin e aktiviteteve dhe projekteve e të dyja entiteteve në fushat e lartcekura lidhura me projektin e lartëpërmëndur;
- iii. Shkëmbimi i përvojave, praktikave, ekspertizave dhe literaturës në fushat përkatëse;
- iv. Zhvillimin e programeve hulumtuese, projekteve kërkimore shkencore, dhe projekteve të tjera të cilat janë me interes për të dy entitetet;
- v. Organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve, dhe bashkëpunime të tjera profesionale;
- vi. Organizimin e punës praktike për student dhe nëpunës tierë pranë të dyja entiteteve sipas kërkesave përkatëse, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve.



Neni5

Dispozitat përfundimtare

- i. Kjo marrëveshje shërben si bazë dhe kornizë për zhvillimin e aktiviteteve dhe iniciativave me interes të përbashkët që do të zbatohen gjatë implementimit të projektit NaturKosovo.
- ii. Duke iu referuar shërbimeve të mundshme kërkimore dhe studimore që RTM mund të ketë nevojë në kuadër të projektit, Palët bien dakord të vazhdojnë me një identifikim të përbashkët të burimeve njerëzore që do të angazhohen brenda një liste profesionistësh të sugjeruar nga Universiteti.
- iii. Pronësia e produkteve të prodhuara në kuadër të këtij bashkëpunimi i mbetet RTM-së, por disponueshmëria e tyre do t'i garantohet pa pagesë Universitetit.
- iv. Palët marrin përsipër të garantojnë shikueshmëri adekuate dhe reciproke për produktet e bashkëpunimit të tyre në përputhje me rolet në prodhimin e tyre.
- v. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet ose plotësohet me pajtimin e palëve;
- vi. Memorandumi nënshkruhet në 4 (katër) ekzemplar origjinal dhe secila nga palët i mban nga 2 (dy) të tilla;
- vii. Kjo marrëveshje nuk obligon palët për ndonjë obligim financiar të ndërsjellt.

Neni6

Hyrja ne fuqi dhe kohëzgjatja

Ky memorandum hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga palët, dhe mbetet në fuqi mbetet në fuqi deri në përfundimin e projektit NaturKosovo


Ne emër të Universitetit "Haxhi Zeka" dhe OJQ "Volontari nel Mondo RTM", në të poshtë nënshkruarit deklarojnë vullnetin për bashkëpunim në mes të dy entiteteve.


Për: Universitetin "Haxhi Zeka"

Për: Volontari nel Mondo RTM


Prof. Dr. Armand Krasniqi




Përfaqësues Ligjor, Valentina Gjinaj



| | | |
|---|---|---|
|  | REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË | UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË |
| REKTORATI | | |
| Nr. / Br. / No. <u>1477</u> | Nr. i faq / Br. str / No. pg <u>2</u> | |
| Data / Datimi / Date <u>07 / 06 / 2023</u> Pejë / Pejë | | |